# DËSHMI ARKIVI

**A-454006**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Çmontohet organizata kriminale shqiptare në Spanjë, sekuestrohen 2.7 ton kokainë dhe 29 makina luksoze – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/cmontohet-organizata-kriminale-shqiptare-ne-spanje-sekuestrohen-2-7-ton-kokaine-dhe-29-makina-luksoze/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 06:56:33 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 06:52:46 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `54974e27267054f006ed1b3e88a6e4639b3addf1b754893d6b9b18dbc0c0121d` |
| TEKSTI | `88c9dafafa9fc55eb14c697647c1c41bb8e378b6dfaad54c88628a378089b2f9` |
| PAMJA | `75601adfa865da823da4465e180f0d0e5833a5c985dc4c20e2d29a9eec2f436d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ad639147322d8f856c061723be5e4815e91640d5629f2ae81a2ecc4a1af0ae9e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `3cbdf23231ddbe1301737130b50cb215bb8d138f7bee92a7c7c6c6c8c9c45afe` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ad639147322d8f856c061723be5e4815e91640d5629f2ae81a2ecc4a1af0ae9e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

5 Rikthehet në vëmendje "Lugina e Ujqërve", seriali i rekordeve nën...

**Policia Kombëtare spanjolle** ka shkatërruar një organizatë kriminale shqiptare, e dyshuar për importimin dhe eksportimin e sasive të mëdha të kokainës drejt vendeve të tjera europiane.

Operacioni, i nisur në vitin 2025 në bashkëpunim me autoritetet ndërkombëtare, është zhvilluar kryesisht në Andaluzi, Katalonjë dhe zona të tjera të Spanjës.

Hetuesit zbuluan se grupi transportonte drogën nga Kolumbia drejt zonës së Campo de Gibraltar dhe më pas e lëvizte me makina drejt destinacioneve në veri të Europës.

Sipas policisë, organizata përdorte metoda të sofistikuara vëzhgimi. Udhëtimet e shkurtra, komunikimet e kufizuara telefonike dhe takimet e drejtpërdrejta mes drejtuesve tregonin një nivel të lartë organizimi.

Në kuadër të operacionit janë arrestuar 15 persona, ndërsa autoritetet kanë sekuestruar:

- 2.700 kilogramë kokainë;
- 29 automjete luksoze;
- dy armë zjarri;
- bizhuteri;
- pasuri të paluajtshme;
- llogari bankare;

goditja e parë ndaj grupit erdhi më 10 prill, kur policia kontrolloi

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

njëkohësisht tre banesa dhe një punishte në Málaga, Estepona, Marbella dhe Churriana, ku u gjetën 1.434 kilogramë kokainë. Në të njëjtën kohë, në një vilë në Sant Just Desvern, në Katalonjë, e përdorur si depo, u zbuluan edhe 1.351 kilogramë të tjera.

Hetuesit thanë se disa prej të arrestuarve kishin lidhje familjare dhe se disa kompani të shitblerjes së automjeteve luksoze.

Këto biznese, sipas policisë, shërbenin edhe për sigurimin e automjeteve që përdoreshin në transportet e drogës.

Disa anëtarë të dyshuar të grupit u larguan nga Spanja pas nisjes së hetimit dhe u arrestuan jashtë vendit përmes urdhër-arresteve europiane dhe ndërkombëtare.

Shefi i njësisë UDYCO, Antonio Jesús Martínez Duarte, e cilësoi hetimin si "shumë kompleks", duke theksuar se objektivi i operacioneve të tilla nuk është vetëm sekuestrimi i drogës, por çmontimi i plotë i organizatave kriminale, përfshirë strukturat e tyre financiare.

#organizatekriminale #shqiptare #Spanje

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.
Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



BOTA
**Përshkallëzohen tensionet! Pesë...**
Xhuljana Zhuleku — Sot 00:22




BOTA
**Shkatërrohet rrjeti i p*dofilisë në Itali, 10...**
Xhuljana Zhuleku — Dje 23:47



BOTA
**Tensionet me Iranin, Trump: SHBA-ja ka...**
Xhuljana Zhuleku — Dje 22:57

## Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri * | E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto komentin




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.